**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV**
**TIRANË**

**NR.48/18/1/1/1 AKTI**

# VENDIM
## NJOFTIMI ME SHPALLJE

**Drejtuar: Gjykates se Apelit Administrativ.**

Ne Gjykaten e Apelit Administrativ, vijon te shqyrtohet çeshtja administrative me:

**PADITES:** Pellumb Prençi.

**TE PADITUR:** - Prokuroria e Pergjithshme e Republikes se Shqiperise.
- Presidenti i Republikes se Shqiperise.

**OBJEKTI:**
- Shfuqizim i Dekretit Nr.8744 Dt.15.10.2014 te Presidentit te Republikes se Shqiperise;
- Kthimi i paditesit ne detyren e prokurorit ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Puke;
- Pagimin e pages se paditesit nga momenti i nderprerjes, date 2.11.2013 deri ne ekzekutimin e vendimit te gjyktes;
- Detyrimin e pales se paditur, Prokuroria e Pergjithshme te paguaje ndaj paditesit nje shperblim te drejte;
- Detyrimin e pales se paditur, Prokuroria e Pergjithshme per fshirjen nga dosja personale e prokurorit Pellumb Prençi te mases disiplinore "shkarkim nga detyra";
- Pezullimin e gjykimit te kesaj kerkespadie derisa te zgjidhet çeshtja penale ne ngarkimin tim ne Gjykaten e Shkalles se Pare Shkoder me vendim te formes se prere.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15/2, 17/2, 18, 30, 31, 32/2, 33, 42, 48 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Nenet 1, 3, 6, 13, 14, 17 te Konventes Evropiane te Drejtave te Njeriut, Nenet 10,11 te Deklarates Universale te Drejtave te Njeriut, Nenet 2, 14 te Paktit Nderkombetar (Kartes se OKB-se) lidhur me te drejtat civile dhe politike, Nenet 2, 5 te Paktit Nderkombetar (Kartes se OKB-se) lidhur me te drejtat ekonomike, shoqerore, kulturore, Nenet 1/1/b, 2, te Konventes Nr.11 te OKB-se "Mbi diskriminimin ne fushen e punesimit dhe profesionit", Nenet 1/1,2/2 te Konventes se OKB-se "Kunder tortures dhe denimeve a trajtimeve te tjera mizore, çnjerezore ose degraduese", Nenet 1,36,297/a te K.Pr.Civile, Nenet 1, 2, 9-20, 22, 23/1, 25, 35, 37, 41, 42, 49 e vijues te K.Pr.Administrative, Nenet 4, 7 te K.Pr.Penale, Nenet 2/1, 4/1/2, 8, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 34, 39, 55/1, 56/5 te Ligjit

Nr.8737 Dt.12.02.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e prokurorise ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar me Ligjin Nr.9102 Dt.10.07.2003 dhe Ligjin Nr.10051 Dt.29.12.2008, Nenet 1, 3, 7/a/ç, 10/2/b, 15/a/c, 16/2/b, 17/1/a/c/g, 18/1/b, 21, 34 te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", Nenet 10,11 te Kodit te Etikes se Prokuroreve miratuar nga Ansambleja e Pergjithshme te Prokuroreve Dt.15 Tetor 2005, Nenet 1, 2, 3, 4 e vijues te Rregullores se Prokurorit te Pergjithshem Nr.78 dt.16.04.2010 "Per Kryerjen e inspektimit dhe fillimin e proçedimit disiplinor", Nenet 2/3/5/6/2/a, 9, 10 e vijues te Rregullores se Prokurorit te Pergjithshem Nr.79 Dt.16.04.2010 "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Prokurorise".

Gjykata, bazuar ne Nenin 52 te Ligjit Nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", i ndryshuar dhe ne Nenet 133/b dhe 460 te Kodit te Procedures Civile, ne seancen gjyqesore te dates 20.11.2018, **vendosi te njoftoje paditesin Pellumb Prençi, nepermjet shpalljes, per seancen gjyqesore te dates 18.12.2018 ora 09.15.**

Nje kopie e shpalljes do te afishohet ne kendin e njoftimeve te Gjykates se Apelit Administrativ dhe ne faqen elektronike te kesaj gjykate, nje kopie ne te dy adresat e vendbanimit te paditesit.

**Nje kopje e shpalljes, me konfirmimin e afishimit, t'i kthehet Gjykates se Apelit Administrativ.**

Tirane, me 20.11.2018

**GJYQTARE**
BLERONA HASA